



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-18310 dt. 19/05/ 2025

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Bekim Lestrani, më datë: 29.05.2025 (E enjte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 29.04.2025
2. Propozim-vendim për financimin e projektit "HANDIKOS"
3. Rregullore për plotësimin ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025.
5. Propozim vendim për bartjen e fondeve-të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.
6. Të ndryshme.

Drenas, 19.05.2025



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani
Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-18213 dt. 19/05/ 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 29.04.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani (PDK), Labinot Halilaj (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Egzona Terdevci (VV), Filloreta Bujupi (VV), Selman Qallapeku, Arbër Halilaj (GREEN), Egzon Qorri (LDK), Beqir Kiqina (AAK), Muhamet Kurtaj, Florentina Elezi Leku, Mirlinda Dvorani.

Munguan: Mërgim Pirraku, Milaim Hajdari, Qëndrim Mulaj.

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtorë të drejtorive, si dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur më dt.28.03.2025;
2. Propozim-vendim për shpalljen e Lordit George Robertson, "Qytetar Nderi", i Komunës së Drenasit;
3. Propozim-vendim për shpalljen e z. Javier Solana, "Qytetar Nderi", i Komunës së Drenasit;

4. Propozim-vendim për shpalljen e znj. Madeline Albright, "Qytetar Nderi", "Post mortum", e Komunës së Drenasit;
5. Propozim-vendim për plotësim- ndryshimin e Rregullores komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Drenasit;
6. Propozim-vendim për financimin e projektit "KV Feronikeli femrat";
7. Propozim-vendim për financimin e projektit "KV Feronikeli meshkujt";
8. Propozim-vendim për financimin e projektit "FC Feronikeli 74";
9. Propozim-vendim për financimin e projektit "KH Drenica";
10. Propozim-vendim për financimin e projektit "KFF Feronikeli femrat";
11. Propozim-vendim për financimin e projektit "Klubi Futsalit Drenasi";
12. Propozim-vendim për financimin e projektit "FC Liqeni";
13. Propozim-vendim për financimin e projektit "Klubi i Boksit Drenasi";
14. Propozim-vendim për financimin e projektit "KV Gryka";
15. Plani lokal i veprimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave Drenas 2025-2028;
16. Raporti financiar janar- mars 2025;
17. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi prezantoi rendin e ditës, fjalën e merr Fatmir Baliu.

Fatmir Baliu, vetëm dua me e bërë një pyetje për pikën e muajit të kaluar, pse nuk është në rënd të ditës sot.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha se mbledhja e muajit të kaluar është ndërpre në mungesë të kuorumit edhe pas përpjekjes së dytë për me e vazhduar mbledhjen nuk ka pasur prezencë të mjaftueshme për me vazhduar, kur të jeni të gatshëm me e përgatit pikën e caktojme një datë edhe vazhdojmë.

Mehdin Salihu, siç e dini asambleja është e asamblistëve nëse një propozim i një asamblisti nuk merret parasysh atëherë ne po punojmë kundër vet vetës, asgjë nuk ka këtu të jashtëligjshme, ne jemi marr vesh me e hedhë në votim dhe unë propozoj që ta qesim në votim.

Egzona Terdevci, tha se në seancën e kaluar jemi pajtuar që me pikën e propozuar prej Fatmir Baliut me e fut për diskutim, në parim është dashtë që t'i bartet kësaj seance për me i siguruar propozimet nuk po e kuptoi këtë rezistencën e juaj për me i pranuar propozimet që vijnë prej asamblistëve.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, për me e diskutuar e diskutojmë të pika " Të ndryshme", për me e vendosë si pikë të rendit të ditës, duhet me qenë si propozim- vendim i plotë dhe i bazuar në ligj dhe rregullore.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, për me e vendosë një pikë në rendin e ditës propozuesi duhet me i pas të gjitha të dhënat, se çka po kërkon, çka po synon, sa mjete duhet me u falë. Prej vitit 2000 e deri 2020 i kemi falë, po ashtu edhe në vitin 2021 që ishte pandemia përmes Kuvendit me propozim të miratuar në parlamentin e Kosovës,

pra tri here i kemi falur borxhet dhe për shkak të tyre ne nuk mund t'i përfundojmë disa projektet që i kemi në proces.

Pas kësaj mbledhje mundemi me vazhduar edhe me debatuar dhe me i peshuar të gjitha të mirat dhe të këqijat e atij vendimi, ju mundeni me vendose prapë si pikë të rendit të ditës edhe sot nuk e kam problem.

Egzona Terdevci, tha se ne u pajtuam në parim në seancën e kaluar për me futë si pikë të rendit të ditës për diskutim edhe pse nuk ke propozimi pajtohem që nuk ke propozimi i caktuar me vlera, por ne para pak muajve i kemi falur borxhet e bizneseve dhe si kemi ditë cilave biznese ja kemi fal d.m.th. puna e saktësisë nuk po vjen prej anës së juaj si ekzekutiv. Unë kam kërkuar me i shikuar ato dokumente edhe ende si kam parë është e pa drejt që një propozim që vjen prej një kolegu asamblast veç për tu diskutuar mos me u diskutuar.

Ne si asamblast vazhdimisht po bëjmë kompromise dhe po votojmë propozime që ju na i keni sjellë sot për sot veç për interesin e qytetarëve, kështu që është mirë kur ne tregojmë mirëkuptim në vazhdimësi për propozimet e juaja edhe ju duhet me treguar mirëkuptim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, propozimi i Fatmirit është diçka tjetër, propozimi jonë ka qenë edhe i juaji, një falje e kemi bërë me 100 euro, ja kemi fal të gjithë taksa-paguesve të Komunës tonë.

Labinot Halilaj, tha se ne propozimin e kemi vendorur në rend të ditës, nëse s'ka qenë vullneti i asamblastëve për me diskutuar, sot jemi 30 ditë prej seancës së kaluar dhe tash ne prapë po diskutojmë, e kanë dhënë versionin vet kolegët nuk kanë pas vullnet me diskutuar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës.

Arigon Sinai, kërkoi që pika që e ka kërkuar Fatmiri të futet si pikë e rendit të ditës për faljen e borxheve, pika e mbledhjes së kaluar të futet edhe një herë si pikë e rendit të ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se nëse lejohet me u vendosë si pikë e rendit të ditës prapë në këtë mbledhje, e shfuqizoni pikën që ka qenë në mbledhjen e kaluar e propozoni e futeni në rend të ditës dhe e debatoni.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, unë si kryesues i Kuvendit vendosi që pika e Fatmir Baliut të diskutohet të pika " Të ndryshme", kush është për këtë rend të ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se mundet me formuluar z. Sinani saktësisht pikën e rendit të ditës dhe me qenë pika e 16-të, para të ndryshmeve e 17-ta, të ndryshme kalon të e 18-ta dhe me votuar për rendin e ditës.

Labinot Halilaj, në këtë seancë nuk e propozon si rend të ditës, nuk e di pse të tjerët duhet me e propozuar këtë pikë të rendit të ditës nëse Fatmiri është këtu prezent nuk ka

nevojë askush me ja bërë avokatin, rregulloren jeni duke e shkelur ju, nuk po e shkel kryesuesi, Fatmiri është prezent mundet me e marr fjalën edhe me kërkuar me futë prapë si pikë të rendit të ditës.

Arigon Sinani, kërkoi të vendosët një pikë shtesë në rend të ditës: Kërkesë për faljen e taksës Komunale ndaj bizneseve të Komunës së Drenasit përveç Feronikelit gurthyeseve edhe pompave të derivateve dhe bankave.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se duhet një mbledhje për me e ndryshuar rregulloren është në dorën e juaj nëse doni me e hekë taksën.

Mehdin Salihu, një muaj keni pas afat me u merr me këtë punë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, këtu jemi duke debatuar për rend të ditës, shkojmë me 10 minuta pauzë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha po vazhdojmë mbledhjen pas diskutimit me përfaqësuesit e grupeve në Kuvend dhe u dakordua që me vendosë si pikë shtesë të rendit të ditës: "Diskutimin për formimin e komisionit për tarifa, gjoba dhe ngarkesa", e në kuadër të atij komisioni me u diskutuar edhe propozimet që mundën me pas anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës me pikën shtesë, "Diskutimi për formimin e komisionit për taksa tarifa, gjoba dhe ngarkesa", në kuadër të kësaj me u diskutuar edhe propozimi i Fatmir Baliut dhe propozimet që mundën me pas anëtarët e Kuvendit, kjo pikë kaloi me **23 vota për, 3 kundër, 1 abstenim**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës dhe kaloi, me **25 vota për, 2 kundër, 0 abstenim**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën

1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, me dt.

28.03.2025. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës, e cila kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2.Propozim-vendim për shpalljen e Lordit George Robertson, "Qytetar Nderi", i Komunës së Drenasit.

Egzona Terdevci, a dihet numri i qytetarëve të nderit që ka shpallur Drenasi se mos po kalojnë numrin e qytetareve të tjerë tani po dalim pak keq.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne e kemi formuar një komision edhe Arbëri e ka propozuar po kurrë komisioni nuk ka marr vendim se kush duhet me propozuar, kanë dhe çka duhet me propozuar, derisa nuk kemi një rregullore jam i detyruar sepse unë mundemi me i kryer edhe pa miratimin e Kuvendit numri nuk është i madh i

qytetareve të nderit 12-13 që përfshin figura të rëndësishëm që kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshëm në lirinë e Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e dytë, dhe kaloi me 27 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën 3. Propozim-vendim për shpalljen e z. Havier Solana, "Qytetar Nderi", i Komunës së Drenasit. Me 27vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Propozim-vendim për shpalljen e znj. Madeline Albright, "Qytetar Nderi", "Post mortum", e Komunës së Drenasit. Pasi nuk pati vërejtje, diskutime pika e katërt e rendit te ditës kaloi me 27 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 5. Propozim-vendim për plotësim- ndryshimin e Rregullores Komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Drenasit.

Azmine Gjoka, sa i përket pikës se pestë, ne kemi diskutuar se kjo po vlen vetëm për barnatore a munden me ndryshuar orarin e bizneseve që bëjnë veprimtari rekreative është kërkesa prej vetë bizneseve.

Drejtoresha e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Agnesa Bucolli, e nderuar ky plotësim ndryshim është bërë vetëm për barnatore kërkesa të tjera nuk kanë ardhur për ndryshime.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se Azeminja ka të drejt ka ardhur kërkesa për një bilardo për me punuar deri në ora 2, por duhet me i pa kriteret e lokalit ku është, sepse nëse është në banesë mund t'i shqetësoi banorët gjatë kohës së gjumit nëse ata janë me objekt të veçantë larg objekteve kolektive banesore.

Azmine Gjoka, në rregull nëse bënë një arsyetim, bizneset e lojërave rekreative për të rinjtë e Komunës tonë janë pjesë e rëndësishme e aktivitetit ekonomik lokal duke ofruar lojëra argëtimi për qytetarët veçanërisht për të rinjtë, kufizimi i orarit të punës deri në ora 23:00 ka ndikuar negativisht në të hyrat e këtyre bizneseve dhe ka ulur interesimin e klientëve në shumë komuna tjera në Kosovë. Orari i punës për lokalet e tilla, orari i punës është i zgjatur deri në ora 01:00 ose me shumë duke respektuar qetësinë publike dhe pa shkaktuar probleme të rendit.

Mehdin Salihu, është një gabim se e bërë orarin e bizneseve në shumës a në fakt ju e keni bërë orarin vetëm për një lloje biznesi ndoshta është gabim teknik mua me intereson p.sh. pse dita e shtune kaq herët e rrokë ditë pushimi disa po ju lejohet me punuar 24 orë ose deri në 4 e disave po i cenojmë po ja bëjmë orarin në të ardhmen kanë me u hapur edhe barnatore tjera kështu që duhet me qenë një farë unifikimi jo kështu, dikën e bëjmë me orare e dikën e lejojmë me punuar sa të dojë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Agnesa Bucolli, tha se ju keni qenë edhe pjesë e komisionit e keni zgjedh përfaqësuesin e barnatoreve, ne nuk e kemi marr vet vetiu këtë vendim, ndërsa për gabimin nuk është gabim, sepse kjo është rregullore ne e kemi ndryshuar

vetëm nenin 15 të rregullores jo të gjithë rregulloren dhe orari për barnatoret kujdestare është deri në ora 14:00 të shtunën, ndërsa ato të cilat nuk janë kujdestare, e kanë orarin e rregullt deri në ora 22:00, ndërsa për ato barnatoret që hapen munden me hy edhe në orar të rregullt.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se kjo është një rregullore e cila e detyron një barnatore me punuar pas orarit të rregullt për me pas qytetaret ku me i marr shërbimet afër AMF-QKMF-vë. Mua më ankohen qytetarët që kontrollohen aty se, duhet me ardhur në Drenas me u pajisë me barna, sepse nuk punon një barnatore e caktuar, ata e kanë përcaktuar vet këtë orar dhe ne po e mbrojmë këtë rregullore, prandaj ky është një orar që e kanë kërkuar vetë ata edhe ne duhet me e aprovuar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës e cila kaloi me 26 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 6. Propozim-vendim për financimin e projektit "KV Feronikeli femrat".

Egzona Terdevci, unë po e përcjell shqetësimin në emër të grupit për subvencione të fusha e kulturës, ka subvencione që jepen prej Kuvendit Komunal vetëm për sport, po të kultura të gjitha janë në vlerë 1500 euro. Mua personalisht si Egzonë po edhe si lëvizje po na duket e pa drejt që janë ndarë aq pak mjete për shoqatat e kulturës që operojnë në Drenas, sidomos për dy asambltetë të cilat e pasurojnë secilin aktivitetet publik të Komunës tonë. Nuk e di arsyen që ju ka shtyrë me e marr këtë vendim, por po besoi që kishte mundur me u bërë një proporcion pak më i drejtë në mes sportit dhe kulturës.

Çështja tjetër që na është përcjell neve si asamblist prej komisionit të ankesave nëse mundet me na sqaruar çka ka ndodhë, a janë plotësuar afatet e rregullta për ankesa se një komunikim që na është përcjell është pak shqetësues edhe për problemet që kanë ndodhë për natyrën e komunikimit një Kryetar i Komunës se besoi që është dashtë me u merr me gjera teknike të komisionit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kur unë po kërkoi me ju vendosë edhe juve në komisione nëse jo në komisione të rregullta me qenë vëzhgues, Ministria herë po ma kthen një vendim pozitiv për të njëjtin vendim tri vjet ose dy vjet negativ ligji është i njëjti ligj, komisioni që i ka përcaktuar shumat është komision i pavarur i cili e ka vlerësuar çdo aplikacion, pra kanë aplikuar edhe shoqatat e veteranëve të luftës të cilët nuk kanë përfituar dhe nuk janë ankuar.

Në bazë të shumave që kërkojë qoftë kultura ansamblet, qoftë këta për libra në sektorin e kulturës e përcakton rregullorja sa përqindje të shumës duhet me ja miratuar, pra nuk ka asnjë ankesë në këtë drejtim. I kemi dy ankesa që 15 ditë, një ankesë e kanë shqyrtuar tjetrën nuk e kanë shqyrtuar të ajo pika që e ceke t'i që ke pranuar shqetësuese, pra të kanë kërkuar takim me mua për mos me pas takim kam thënë zbatoni vendimin për të cilin jeni emëruar dhe vazhdoni me vlerësime profesionale. Të gjithë ata që kanë kërkesa të arsyeshme kemi me u munduar me ju ndihmuar siç janë organizatat e luftës, sepse ju kemi ndihmuar edhe përpara.

Egzona Terdevci, faleminderit shumë për pjesën e shoqatave të luftës, po pajtona sepse kërkesa e tyre kishte qene me e mundur me kanë me të shëndetësisë për rehabilitim sesa me të sportit edhe është i arsyeshëm refuzimi nuk po e kuptoi pse kanë kërkuar me e sjell në Kuvend më shpejt kur ato ndër 1500 nuk votohen në Kuvend se the e kanë tërheq ankesën dhe e dërgon në Kuvend. I kam edhe dy çështje tjera, KVRL-ja, nuk mundet me marr projekte si KVRL, munden organizatat brenda KVRL-së, po KVRL-ja është organizatë ombrellë për të gjitha organizatat që veprojnë në kuadër të saj kështu që është gabim me i ndarë mjete KVRL-së. A është bërë aplikimi në emër të ndonjëres prej organizatave që është brenda në KVRL dhe të mjetet për rini nuk e di ndoshta e keni trajtuar dhe jo me marr dy motra prej të njëjtës thirrje mjete, po besoi që është konflikt interesi.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, për shoqatat ata kanë bërë kërkesë për me përdor me shenjëtari mjetet ne nuk kemi të drejt me ju dhënë mjetet për me shkuar ata me gjuajt me armatime, por ne do të mundohemi me i ndihmuar, për KVRL. Nuk e di që janë dy motra, sepse janë komisioni që marrin vendim dhe përgjegjësi.

Arbër Halilaj, është pak e habitshme të pika e rregullores, si të kjo për subvencione me duket që i komplikojmë gjërat pa nevojë, pa ndonjë arsye të rëndësishme.

Kryetari i Komunës ka të drejt të formoj komision për çështje të ndryshme si e ka formuar komisionin për me i shqyrtuar aplikacionet në këtë thirrje të DKRS-së, mirëpo zakonisht është vepruar ashtu që komisioni ka vepruar që komisioni ka raportuar të ne për aplikacionet që janë pranuar, ose ato që janë refuzuar arsyet e refuzimit etj.

Por në këtë rast nuk e kemi këtë raportim me që data për ankesa paska qenë 28.04.2025, unë këtë e kam parë vetëm në portale, sepse personalisht nuk e njoh personin që është kryesues i komisionit, mirëpo kishte qenë e rrugës që ai me raportuar këtu dhe të dimë saktë përveç këtyre nëntë aplikacioneve që janë propozuar që të jenë përfitues në listën përfundimtare sa ka pas në total aplikacione, cilat janë refuzuar dhe cilat janë arsyet e refuzimit, do të ishte një procedurë shumë normale e raportimit.

Unë jam për me e shqyrtuar mundësinë për rritjen e subvencionimeve të aplikantëve nga sferat tjera të aktiviteteve rinore, ndërsa pajtohem me Egzonën që shoqatat e luftës duhet t'i sponzorojmë e financojmë në çdo aktivitet të tyre, mirëpo ata e kanë qendrën në Prishtinë, por duhet të gjenden metoda në mënyra adekuate jo thirrje që kanë të bëjnë p.sh ekskluzivisht me aktivitete të DKRS-së.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, komisioni i ankesave nuk ka të drejt me ardhur me raportuar këtu, por as me njoftuar përmes emailit, sepse është një shkelje e rëndë e cila ka shkuar tashmë të sinjalizuesi do të shkon edhe të hetuesi. Cili do komision e ka pavarësinë e vet me i bërë detyrat e veta, unë as nuk i kam ndërhy, as se kam thirr, më ka shkruar edhe me shqetësim e kam marrë emailin për takim, sepse unë nuk kam të drejt dhe nuk takohem me asnjë komision, sepse komisioni në mënyrë profesionale duhet me e bërë punën e vet edhe me raportua.

Mehdin Salihu, një pjesë të përgjegjësisë e dha kryetari, por për mua personalisht asnjë arsye nuk vlen, mos financimi i shoqatave, kur po kem fushatë po i shfrytëzojmë. Unë e kam një vërejtje konkrete, nëse e shohim listën e fituesve gati të njëjtat klube për çdo herë pse nuk i keni marr parasysh edhe ndonjë klub tjetër ka klube tjera plotë që merren me sport siç është grupi i yjeve dikën e financoni me vlerë shumë të madhe, dikujt nuk ja jepni asnjë cent, bëhuni pak me racional edhe Arbëri e kërkoi më mori mëndja kryetarin e komisionit jo kryetarin e ankesave.

Kryetari i komisionit është dashur më qenë prezent dhe me sqaruar çfarë kriteresh nuk po plotësojnë klubet jo Petriti i jep sqarim Kryetarit, Kryetari dikujt tjetër, është organi kompetent, disa i financojnë për çdo vit, disa hiq kush e ka dikën përfiton, kush nuk ka mbetet aty ku është.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, duhet me e lexuar raportin deri në fund, rregulloren duhet me e ditë mirë. Me rregullore Kuvendi më ka autorizua me bërë pagesa deri në 1500 euro, përmes Kuvendit por jo pa e shqyrtuar një komision i caktuar. Asnjë klub, asnjë OJQ, nuk është refuzuar nëse i ka plotësua kriteret, e për shoqatat e luftës jam duke e shqyrtuar mundësin për me ju ndihmuar me atë të drejtë që ma ka dhënë Kuvendi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës e cila kaloi me 27 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 7. Propozim-vendim për financimin e projektit "KV Feronikeli meshkujt". Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e shtatë të rendit të ditës, e cila kaloi me 25 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 8. Propozim-vendim për financimin e projektit "FC Feronikeli 74".

Egzona Terdevci, prej se e kemi marr mandatin prej vitit 2021, në vazhdimësi ne kemi ndarë më së shumti mjete për "FC Feronikeli 74", njëherë për atë të vërtetën pastaj për këtë modifikimin që është bërë më vonë po asnjëherë askush nuk ka dhënë përgjegjësi para neve si Komunë si asamblist që e financojmë me një shumë kaq të madhe Feronikelin.

Për dështimin e Feronikelit të kaluar kur nuk është sqaruar tamam furnizimi i tij me "FC Fortunën", prej aty sa kam informacione unë lojtarët ende vazhdojnë me pas raste në gjykata për borxhet që nuk ja ka paguar "FC Feronikeli 74".

Tash është pak absurde që "FC Feronikeli 74", thirret në trashëgiminë sportive të Feronikelit të kaluar, po përgjegjësi nuk ka marrë askush për veprimet e Feronikelit tjetër dhe nuk po e kuptoi pse duhet me e ndarë një shumë kaq të madhe për një klub i cili nuk është përmirësua në organizim nëse dikur "FC Feronikeli 74" ka qenë krenaria e qytetit, sot "FC Feronikeli 74" është që Drenasi me u njoh për keq, për shkak të keq organizimit dhe keq menaxhimit nuk besoi se si Kuvend Komunal si asamblist ishte dashtë me u bërë pjesë e një keqpërdorimi të menaxhimit të një klubi i cili u transformua për interesa personale të grupeve të caktuara.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Feronikeli qoftë "FK, FB, FC Feronikeli 74", ka më se tri vite që nuk e ka marrë asnjë cent subvencionim nga Komuna, Feronikeli ka qenë krenaria dhe vazhdon me qenë krenaria. Koha e pandemisë e ka shkatërruar Feronikelin sikur edhe shumë institucione të tjera dhe OJQ tjera dhe ka mbet me borxhe, u furnizua sepse ligji e ka lejuar dhe e lejon, prandaj ju thërras që ta votoni, është e drejt e juaja me votuar ose jo.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e tetën të rëndit të ditës, e cila kaloi me 23 vota për, kundër 0, abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 9. Propozim-vendim për financimin e projektit "KH Drenica".

Egzona Terdevci, të propozim-vendimi "KH Drenica", është një gabim teknik te pika e parë dhe pika e tret është KH Drenica, kurse të pika dytë ka mbete klubi i shigjetarisë vetëm me e përmend që duhet me u bërë një përmirësim.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e nëntë të rëndit të ditës me përmirësimin teknik që duhet të bëhet, edhe kjo kaloi me 25 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 10. Propozim-vendim për financimin e projektit "KFF Feronikeli femrat". Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e dhjetë të rëndit të ditës, e cila kaloi me 25 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 11. Propozim-vendim për financimin e projektit "Klubi i Futsalit Drenasi". Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e njëmbëdhjetë rëndit të ditës, e cila kaloi me 23 vota për, kundër 0, abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 12. Propozim-vendim për financimin e projektit "FC Liqeni"

Egzona Terdevci, nese të dyjat e kanë të njëjten veprimtari që ju ndajtm mjete me hëret edhe ky tash nuk po e kuptoj këtë diskriminim të mejeveve financiare, mundet me qenë pak pikë epersi në tabelë e kuptoi atë pjesë, por me gjithatë edhe FC Liqeni, vazhdon ende të mbetet në lojë, ka potencial ka lojtare të jashtëzakonshem dhe menoj që ishte dashur me pasë një motivim shtesë mos me qenë dallimi aqë i madhë me mjete financiare, propozoi që t'i ndahen mjete me shumë më të madhe për FC Liqenin.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, klubet i kanë paraqitë kërkesat e veta dhe komisioni i ka vlerësuar me këtë shumë, nuk jeni ju që vendosni me shtuar ose me i hekë, jeni këtu për me votuar për ose kundër, sepse një komision i pavarur i ka vlerësuar dhe i ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet duke përfshirë edhe aplikacionet e këtyre dy klubeve. Unë nuk ndërhyjë në asnjë komision, sepse nuk kam kohë me u merr me asnjë komision.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e dymbëdhjetë të rëndit të ditës, e cila kaloi me 24 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 13.

Propozim-vendim për financimin e projektit “Klubi i Boksit Drenasi”. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e trembëdhjetë të rëndit të ditës, e cila kaloi me 24 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 14.

Propozim-vendim për financimin e projektit “KV Gryka”. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e katërbëdhjetë të rëndit të ditës, e cila kaloi me 25 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 15. Plani lokal i veprimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave, Drenas 2025-2028.

Egzona Terdevci, është një pikë shumë e mirë sigurimi i strehimit afatgjatë për viktimat e dhunës në familje dhe viktimave të dhunës me bazë gjinore, po dua me ditë a ka me filluar me që strategjia përfshin vitin 2025 a ka me filluar kjo në vitin 2025 dhe a ka Komuna të dhëna se sa është numri i grave dhe vajzave që mund të kenë nevojë për strehim pra brenda vitit 2025.

Po ashtu një formë tjetër që kishin mundur me e ndihmuar nuk e di nëse keni mundësi me e përfshi në strategji apo në plan që e keni bërë është që me i subvencionuar me qira aty ku s’mundën me ju siguruar banesa. E kam të qartë që Komuna nuk mundet me i pajis të gjithë me banesa, po a kemi mundësi me e bërë edhe mbulimin e shpenzimeve mujore për vajzat dhe gratë që janë viktima të dhunës në familje.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, për këtë plan është dashur me qenë Zahrie Podrimqaku këtu, po ka pasur rast vdekje. Nuk e di sa ka vajza edhe gra që kanë kërkuar ndihmë, por nëse është nevoja ne i financojmë e kemi një përqindje të caktuar në kuadër të nivelit rajonal ku bëjnë pjesë në kuadër të Prishtinës dhe qyteteve të tjera të Kosovës dhe aty e ndajmë buxhetin për ato në bazë të përqindjes që na takon.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e pesëmbëdhjete të rëndit të ditës, e cila kaloi me 18 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 16. Raporti financiar janar- mars 2025.

Egzona Terdevci, unë i kam disa pyetje, në faqen 4 të raportit e kam diskutuar edhe herëve të tjera bëhet fjalë për zërin e njëjtë kontabël shitja e pasurisë publike, vlера është 1 euro, a mundem me e ditë a është gabim teknik, nuk e di pse është paraqit dy herë si pozicion i njëjtë zë kontabël qiraja nga vendosja e objekteve tregtare në faqen 3 vlера 16 mijë e 856 euro, kurse të faqja 4 vlера është zero nëse mundem me e ditë çka ka ndodhë.

Te faqja 4 e raportit vërehet një rritje e madhe e taksave të pozicioni i taksës për ndërrim të destinimit të tokës në raport për dy vitet e kaluara. A mundem me ditë sa është numri i tokave që janë ndërruar ose pse është duke ndodhe një rritje kaq e madhe, si dhe sa është vlera e shpenzimeve për gjykata dhe përmbarues në këtë tre mujor, e kam parë që e keni sqaruar në raport që është marrë prej se cilës kategori të subvencioneve, por nëse mundemi me ditë shumën e saktë sa janë shpenzua për gjykata dhe përmbarues për tre mujorin e parë.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Hapësinorë Petrit Gashi, sa i përket rritjes rreth ndërrim destinimit të tokës pse u rrit më shumë me hartat e reja zonale d.m.th, janë rritë edhe zonat tjera të ndërtimit të cilat janë detyruar prej tokës bujqësore me kaluar në tokë ndërtimore. Edhe në bazë të rregullores, ne duhet që tokën bujqësore kur kalon në tokë ndërtimore e ka një çmim të caktuar dhe bëhet ndërrim destinimi i tyre para se të pajisen me leje ndërtimi.

Kjo ka ndodhë edhe për shkak të rrugës kryesore, sepse 200 metra në të gjitha rrugët d.m.th është bërë zonë me interes të përgjithshëm që do të thotë zonë për shërbim tregtarë kanë të drejt ndërtimi jashtë komasacioni, dhe për këtë arsye të gjithë ato toka bujqësore është dashur me u kthyer në tokë ndërtimore dhe për këtë arsye është rrit vlera e inkasimit.

Drejtoresha e Drejtorisë së Financave Albulena Saliuku, sa i përket pjesës së kodit 50-407, qiraja nga vendosja e objekteve tregtare d.m.th janë disa pagesa të cilat janë kryer nga IPKOS, dhe kemi një rritje me qenë se pagesat kanë qenë të rregullta. Po ashtu sa i përket partive politike të cilat e kanë shfrytëzuar objektin për qira ndërkaq të kodi tjetër, vlera është e ndryshme së varësisht prej kërkesave është bërë edhe shfrytëzimi i objektit.

Egzona Terdevci, të shitja e pasurisë publike vlera është 1 euro Kryetari i Komunës në fillim të seancës e ceku së na i kanë marr nëse nuk gabo 1 milion e 150 mijë euro, për tre mujorin e parë tash u dha një shifër tjetër a mundeni mëma shpjeguar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, në prill na kanë tërhequr mjetet edhe në mbledhjen e kaluar kemi raportuar, janë dëme që kanë me ndikuar në projekte, s'kemi me mundur me i realizuar, për shkak se na i kanë marr mjetet deri tani.

Drejtoresha e Drejtorisë së Financave Albulena Saliuku, sa i përket pjesës së këtij kodi e kemi diskutuar edhe në dy seancat e kaluara. Në fund të vitit janë bërë rregullimet sa i përket 1 euro vetëm nëse ka qenë ndonjë kërkesë, por nëse kërkon informata shtesë, ne mund të marrim nga zyrtari përkatës.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, për shkak të mungesës së kuorumit mbledhja u ndërpre në ora 12: 22 minuta .Mbledhja vazhdojë më 29.04.2025 prapë në ora 14:41, në Kuvendin Komunal Drenas.


Egzona Terdevci, herave të tjera kur të ndërprehen mbledhjet kishte qenë më mirë që gjatë mbledhjes me e caktuar një orar se kur planifikohet me vazhduar, se kështu njerëzit po shpërndahen edhe tani nuk po vijën.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, tha se anëtarët e Kuvendit janë të njoftuar nëse ndërprehet mbledhja që duhet me e bërë edhe një tentim për me e vazhduar diskutimin për pikat e rendit të ditës, pra ajo nënkupton që kemi me vazhduar, se nuk është mbyllur mbledhja, dhe vazhdojmë me përpjekjen e dytë me qenë se nuk kemi kuorum të mjaftueshëm me i diskutuar pikat që kanë mbete, mbledhjen e shpalli të përfunduar.

Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit, të dt. 29.04.2025 mund ta ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social.
<https://ëëë.facebook.com/share/v/1ZvsdqXvjp/>
[https://ëëë.facebook.com/share/v/1685iGzK11.](https://ëëë.facebook.com/share/v/1685iGzK11)


Mbledhja përfundoi në ora.14:45.

Procesmbajtësja



Farkete Hoti


Lekturoj



Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas (Glllogocit)
Kuvendi Komunal



01- Nr 400/01-17299 dt. 12/05/ 2025

Në veshtrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr.020/04-12697, të dt. 07.04.2025, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2025, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

**PROPOZIM VENDIM
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT**

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2025.

Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- “Ofrimi i Shërbime Sociale dhe rehabilituese sipas standardeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, përkrahet në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2025.

Neni 3

Financimi - Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të parapara me Buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Neni 5

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal të Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

Arsyetimi

Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni me Vendimin 01 Nr.020/04-12697, të dt. 07.04.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06-400/01-11701 të dt. 01.04.2025, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2025.

Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartëcekur, ku gjithsej kishin aplikuar pesë (5) OJQ:

Pas hapjes së zarfeve të OJQ-ve aplikuese, komisioni ka verifikuar dokumentacionet e dorëzuara të 5 organizatave aplikuese, si përfitues përcakton për mbështetje financiare Shoqatën e Përsoneve me Aftësi të Kufizuara "HANDIKOS" Drenas.

Meqë vlera e përkrahjes financiare në bazë të thirrjes publike është 5.000 €, kjo shumë do t'i ndahet kësaj OJQ-je, financimi- subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të paraparë me Buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryetarit



Nr.01- 400/21-17615 dt. 13/05/2025

Në harmoni me nenin 2 të ligjit nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal, nenit 27 të LMFP nr. 03/L-048, nenit 9, paragrafi 6 i ligjit nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR
BARTJEN E FONDEVE -TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

Neni 1

Me këtë propozim, kërkohet bartja e mjeteve financiare të balanceve të pashpenzuara të të hyrave vetanake të vitit paraprak(2024) në vitin 2025.

Neni 2

Të hyrat vetanake për bartje nga bilancet e pashpenzuara janë gjithsej 486,469.62 € përkatësisht, fondi burimor 21 në shumën 359,871.06 € dhe fondi burimor 22 në shumën 126,598.56 €.

Neni 3

Bilancet e pashpenzuara barten në këto kategori ekonomike të shpenzimeve:

Mallra dhe Shërbime.....9,813.86 €,
Shpenzime Komunale.....74.42 €,
Subvencione dhe Transfere5,447.77 €,
Investime Kapitale.....471,133.57 €.

Neni 4

Shuma e mjeteve për bartje nga bilanci i pashpenzuar i fondit 21 dhe 22

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën-programet:

Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100),.....3,598.30 €
Arsimi Parashkollor (92210),.....5,964.46 €
Administrata(16301),.....251.10 €

Në kategorinë e shpenzimeve Komunale në nën-programet:

Infrastruktura Rrugore(18001),.....74.42 €

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën-programët:

Zyra e Kryetarit (16001),.....	3,500.00 €
Administrata (73010),.....	1,622.46 €
Infrastruktura Rrugore(18001),.....	325.31 €

Në kategorinë e shpenzimeve Investime Kapitale:**Nën-programi Infrastruktura Publike (18161) në projektet:**

“Rregullimi I trotuarëve dhe ndriqimi publik Drenas,Komoran,Arlat”,kodi (53635).....	55,851.34 €
“Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit“ Fehmi e Xhevë Lladrovci” Drenas,kodi (49297).....	865.99 €
“Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas”, kod(48661).....	92,727.18 €
“Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza Drenas-Dobroshec,kodi (53631).....	110,772.20 €
“Asfaltimi i rrugës në fshatin Abri e Epërme,Terdec, kod(53670)	39,445.00 €
“Asfaltimi i rrugës Baicë,Krajkovë,Damanek,Shtrubullovcë,kodi (51340)	12,175.70 €
“Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulët dhe E.,Korroticë e Ulët dhe E.,kodi (48658)	7,052.71 €
“Ndërtimi,zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas, kod(53660),	53,777.19 €
“Asfaltimi i rrugëve në fshatin Nekoc dhe Kizhnarekë, kod(53672)	15,474.72 €

Nën-programi Shërbimet Kulturore (85001) në projektin:

“Fusha sportive dhe rekreacion ne Arrllat dhe Llapushnik”,kodi(54014)	11,385.66 €
---	-------------

Nën-programi Infrastruktura Rrugore (18001) në projektet:

“Rregullimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi, kod(53364).....	20,261.50 €
“Sinjalizimi Vertikal dhe horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve”,kodi(53316)	2,804.00 €
“Zgjerimi i kamerave në Drenas dhe Komoran”,kodi(53341).....	3,818.25 €

Nën-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66310) në projektin:

“Vendosja e sistemit të adresave, tabelave dhe numrave, kod(53736),.....	780.96 €
--	----------

Nën-programi Arsim fillor,mesëm i ulët (93000) në projektin:

“Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut,kodi (49194)).....	2,740.17 €
---	------------

Nën-programi Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) në projektet:

“Pajisje speciale mjeksore mbi 1000”, kod(49181).....	31,201.00 €
---	-------------

Nën-programi Shërbime Sociale(75501) në projektin:

“Veturë zyrtare për stafin e qendrës për punë sociale” ,kodi(54135),.....	10,000.00 €
---	-------------



Kryetari I Komunës
Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Dedikimi i këtyre mjeteve sipas nën-programeve dhe kategorive ekonomike është në pajtim me nenin 6 të ligjit 08/L-332 të hyrat vetanake komunale nga arsimi dhe bashkëpagesat e kujdesit primar shëndetësor të cilat regjistrohen veçmas dhe si të tilla autorizohen dhe shfrytëzohen vetëm nga to. Bartjet e bilanceve të pashpenzura të vitit paraprak ndahen në kategori ekonomike për mbulimin e obligimeve kontraktuale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryetarit



Nr.01- 400/b/a 17613 dt. 13/05/2025

Në harmoni me nenin 2 të ligjit nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal, nenit 27 të LMFP nr. 03/L-048, nenit 9, paragrafi 7 i ligjit nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR
RRITJEN E BUXHETIT NGA TEJKALIMI I PLANIT TË TË HYRAVE
VETANAKE PËR VITIN 2024 DHE BARTJEN NË VITIN 2025

Neni 1

Me këtë propozim, bëhet rritja dhe bartja e mjeteve financiare nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake në vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025 në shumën prej 467,023.99 euro.

Neni 2

Rritje dhe bartja e mjeteve financiare bëhet në këto kategori ekonomike të shpenzimeve:

Mallra dhe Shërbime në shumën 25,167.50 euro në nën-programet:

Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor (73100) shuma 9,937.50 euro,

Arsim parafillor (92210) shuma 15,230.00 euro.

Investime Kapitale në shumën 441,856.49 euro në nën-programin:

Infrastruktura Publike (18161) në projektin nr.49297 "Zgjerimi dhe Ndërtimi i Sheshit "Fehmi e Xheva Lladrovci", në shumën 441,856.49 euro.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Dedikimi I këtyre mjeteve sipas nën-programeve dhe kategorive ekonomike është në pajtim me neni 6 të ligjit 08/L-332 të hyrat vetanake komunale nga arsimi dhe bashkëpagesat e kujdesit primar shëndetësor regjistrohen veçmas dhe si të tilla autorizohen dhe shfrytëzohen vetëm nga to. Kategoria e Investimeve kapitale, financohet me buxhet shtesë për arsye të ndikimit negativ nga vendimet e formës së prerë të përmbarimit/gjykatës për obligimet e kontratave kolektive.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-18316 dt. 19/05/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gaz. Zyrt. e Republikës së Kosovës”) dhe Rregullores Nr. 02 Nr.400/03-62198, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 29.05.2025 të aprovoj:

**RREGULLORE PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA**

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 02 Nr.400/03-62198 të dt. 28.12.2023.

Neni 2

Shtohet tek Neni 24 paragrafi – 1.5.1 Inspektori I mjedisit konstaton shkelje të nenit 14 të Rregullores Nr. 02 Nr.400/03-62198 përkatësisht shqipton masa ndëshkuese kur subjekti apo personi fizike ka kontratë me kompani të licencuar për largimin e mbeturinave (Posedon kontejnere) por shfrytëzon kontejnerët komunal apo kontejner të personave tjerë për hedhje të mbeturinave.

Shtohet tek Neni 24 paragrafi – 1.5.2. Inspektori I mjedisit merr masa ndëshkuese nëse konsaton se nuk është kryer shërbimi për largimin e mbeturinave sipas intenerarit (Orarit) të caktuar nga komuna për kompaninë e licencuar për largimin e mbeturinave.

Shtohet tek Neni 24 paragrafi – 1.9.1. Inspektori i Shërbimeve Publike merr masa nëse: Dëmtohen Objektet komunale – publike apo bënë ndërhyrje pa pëlqim të organeve kompetente tek: a).rrjeti i tërësishëm i ujësjellësit dhe bënë ndërhyrje apo mbyll kanalet atmosferike , b). rrugët dhe trotualet, c).sheshet, Ç).hapësirat për parking, d). sipërfaqet publike të gjelbërta, dh). pajisjet për ndriçim publik; e). tabelat për shpallje, ë). panot ndriçuese, reklamat, f)largon apo dëmton kapakët e pusëve,dhe të gjitha objektet tjera të cilat, sipas destinimit që kanë, mund të konsiderohen objekte komunale. Në rastë se personi fizik, përsoni përgjegjes i personit juridik apo personi juridik i cili nuk respekton urdhëresën e inspektorëve, atëherë do të mirren masa sipas rregullores në fuqi.

Shtohet tek Neni 24 paragrafi 1.9.2. Inspektori I shërbimeve Publike bënë mbikqyrjen e hapësirave publike të cilat shfrytëzohen me anë te terasave të hapura dhe të mbyllura, mbikqyrë

[Signature]

kontratat e shfrytëzimit të hapsirave publike më pak se një (1) vitë dhe të tjera, ku merr masa për shfrytëzimin e hapësirave publike të cilat shfrytëzohen pa leje të organeve kompetente që shfrytëzohen nga personat Juridik, personat përgjegjës të personave juridik dhe personave fizik

Shtohet tek Neni 24 paragrafi 1.9.3. Inspektori I Shërbimeve Publike merr masa nëse: Kryesi i punëve (personat juridikë, personat përgjegjës të personave juridik dhe personat fizikë), menjëherë pas kryerjes së punëve, në afatin të cilit e ka caktuar organi kompetent me rastin e dhënies së lejes për të punuar apo për kyqje janë të obliguar që materiali i tepërt të mënjanohet nga rrugët, trotualet, sipërfaqet publike dhe terrenin ta kthejnë në gjendjen e mëparshme. Në rast se nuk respekton urdhëresën e Inspektorëve, inspektorët do të marrin masa sipas rregullores në fuqi.

Shtohet tek Neni 24 paragrafi 1.9.4. Inspektori i shërbimeve Publike merr masa nëse: Ndërmarrjes të cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së hapësirë publike – gjelbërimet është e obliguar: a) t'i largojë menjëherë degët e dëmtuara nga kushtet natyrore atmosferike ose nga shkaktar të tjerë, b) të largojë barin e kositur dhe materialin e mbetur në sipërfaqet e gjelbërta publike.

Shtohet tek Neni 24 paragrafi 1.9.5. Inspektori i Shërbimeve Publike merr masa nëse në sipërfaqet e gjelbërta publike bëhet: a) vozitja dhe parkimi i automjeteve (i të gjitha llojeve), si dhe shkarkimi dhe deponimi i çfarëdo materiali në këto sipërfaqe; b) largimi, djegia, dëmtimi i shenjave dhe mbishkrimeve të vendosura me qëllim të mbajtjes së rendit; c) shtrirja dhe qëndrimi nëpër sipërfaqe të gjelbërta, lëvizja jashtë rrugicave të shënuara për këmbësorë; d) rrëmihja për çfarëdo destinimi, pa u pajisur me leje nga organi kompetent; e) keqpërdorimi i ujit në fontana (hyrja në to, larja e personave dhe gjësendeve, turbullimi i ujit); f) vendosja e materialeve ndërtimore apo çfarëdo materiali tjetër statik (vazo, tavolina, mjete të ndryshme) në trotuar, rrugë, hapësira gjelbëruese, parkingje etj .

Shtohet tek Neni 24 paragrafi 1.10.1. Inspektori I mjedisit përkatësisht shqipton masa ndëshkuese kur subjekti apo personi fizike ka kontratë me kompani të licencuar për largimin e mbeturinave (Posedon kontenjere) por shfrytëzon kontenjerët komunal apo kontenjer të personave tjerë për hedhje të mbeturinave.

Poashtu tek Neni 24 pas paragrafit në fund 1.32. shtohen këto paragrafe:

1.33. Inspektori i Komunikacionit merr masa nëse: Bëhet dëmtimi i shenjave të komunikacionit, vendosja e policëve të shtrirë në rrugë pa pëlqimin e organeve kompetente, dëmtimi i shenjave të emërtimit të rrugëve apo largimi i tyre si dhe dëmtimi/largimi i pahive të rrugës.

1.34 Inspektori I mjedisit merr masa ndëshkuese nëse konsaton se nuk është respektuar leja mjedisore komunale nga subjekti apo personi juridike që e posedon lejen mjedisore komunale apo nuk pajiset me leje mjedisore komunale pas urdhëresës së dhënë nga inspektorët.

1.35 Inspektori I mjedisit merr masa ndëshkuese nëse kompania e kontraktuar për mirëmbajtje të kanalizimeve nga organi kompetent nuk i përmbahet kontratës.

1.36. Inspektori i Tokës Bujqësore merr masa : Nëse gjatë inspektimit në teren vëren shtrirje të zhavorit (materialit të forte) në tokën bujqësore.

1.37. Inspektoret për punët në leminë e tyre shqiptojnë gjobë mandatore nëse pala brenda afatit të dhënë nga inspektori nuk e respekton urdhëresën e dhënë nga inspektorët dhe nuk prezanton dokumentacionin e kërkuar .

1.38. Inspektoret për punët në leminë e tyre marrin masa nëse: Personat juridikë, personat përgjegjës të personave juridik dhe personat fizikë, në vendëpunishte nuk kanë të vendosur mbishkrimin e kontraktuesit në vendëpunishte, shenjëzimin e rrezikut dhe rrethojën.

1.39. Inspektorët në lëmi të ndryshme mund të marrin masa nëse pala nuk është pajisur me dokumentacion brenda afatit të dhënë dhe inspektori nxjerr vendimin që brenda 8 dite të bëhet përmirësimi apo kthimi I gjendjes në atë të mëparshme .

1.40. Inspektori merr masa edhe pas orarit të punës apo gjatë vikendeve të përcaktuara nga eprori si orar I kujdestarisë në të cilat vërehen parregullësi në të gjitha sektorët e Drejtorisë së Inspekcionit.

Neni 3

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Pas hyrjes në fuqi të Rregullores Nr. 02 Nr.400/03-62198 dt.28.12.2023, neni 24 ka nevojë për disa paragrafe shtesë që Inspektorët komunal të marrin masa e duhura sipas pikave të përmendura më lart, pasi në teren hasin problematika të shumta të këtyre natyrave. Këto ndryshime nuk kanë qenë të përfshira në rregulloren e lartëcekur andaj, kërkohet nga ana e kryetarit të komunës që të bëjë Plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 02 Nr.400/03-62198 të dt. 28.12.2023.

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025, ka miratuar Vendimin 02 Nr. 400/03-11633 për ndryshim plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Vendimi 02 Nr. 400/03-11633 për ndryshim plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Neni 12 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës përcakton se “plotësim ndryshimi i një akti normativ të komunës bëhet me akt të njëjtë duke respektuar procedurat ligjore”, andaj plotësim ndryshimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Glllogocit nuk mund të bëhet me Vendim, por duhet të bëhet Rregullore për plotësim ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Glllogocit.

Andaj Kuvendi i Komunës së Glllogocit ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në përputhje me kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke korrigjuar pjesën hyrëse të aktit ashtu siç është rekomanduar. Pjesa tjetër e dokumentit ka mbetur e pandryshuar, në pajtim të plotë me vlerësimin dhe udhëzimet e dhëna nga MAPL.